



WIN –
Women & Men Innovating &
Networking for Gender Equality



Women, Economy & Environment



Shënime Konceptuale Paraprake

Tryezat e Rrumbullakëta të Specializuara

Rritja e Ndjeshmërisë Gjimore dhe e Përfshirjes së Aftësisë së Kufizuar për Uljen e Rrezikut të Fatkeqësive (URF) Politikat dhe Menaxhimi

Aktivitet në internet

Azia Qendrore dhe Mongolia - 22 nëntor 2021

Evropa Juglindore - 23 nëntor 2021

Programi i Çështjeve Gjimore të Sekretariatit të OSBE-së organizon tryeza të rrumbullakëta të specializuara me qëllim diskutimin e rritjes së ndjeshmërisë gjimore dhe përfshirjes së aftësisë së kufizuar në politikat dhe menaxhimin e Uljes së Rrezikut të Fatkeqësive (URF),.

Konteksti

Rreziqet natyrore dhe ato të krijuar nga njeriu janë bërë gjithnjë e më shumë të shpeshta dhe e kanë fuqinë të shkatërrojnë jetët dhe mjetet e jetesës së personave. Si të tilla, ato përbëjnë rrezik të madh sigurie, edhe brenda zonës së OSBE-së.

Vendimi i Këshillit Ministror të OSBE-së për Përmirësimin e Uljes së Rrezikut të Fatkeqësive (MC.DEC/6/14) nxit Shtetet pjesëmarrëse të (...) *brendatrupëzojnë njohuritë dhe informacionet vendase në planet kombëtare, duke marrë parasysh si aftësitë e burrave edhe ato të grave, si edhe cenueshmëritë e posaçme të fëmijëve, grave, të moshuarve, të varfërve dhe atyre me aftësi të kufizuara, si dhe të angazhojnë në mënyrë veprorë të gjithë aktorët përkatës, duke përfshirë po qe e përshtatshme edhe autoritetet vendore, shoqërinë civile, sektorin privat, median dhe sferën akademike në të gjitha fazat e uljes së rrezikut të fatkeqësive. (...)*

Shpesh, gratë dhe vajzat janë më të cenueshme si pasojë e normave shoqërore, detyrimeve familjare dhe qasjes së kufizuar në pushtet dhe në burime. Faktorët si mosha, klasa shoqërore, etnia, aftësia e kufizuar, etj. i shumëfishojnë këto cenueshmëri. Personat me aftësi të kufizuara përballen me vështirësi të posaçme. Përqasja gjithëpërfshirëse për Uljen e Rrezikut të Fatkeqësive (URF) bën të mundur që grupet e prekura të përfaqësohen përgjatë ciklit URF, që nga planifikimi dhe përgatitja, deri tek reagimi dhe rimëkëmbja.

Për ta bërë URF-në më përfshirëse dhe të efektshme, Programi i Çështjeve Gjimore të Sekretariatit të OSBE-së organizon dy tavolina të rrumbullakëta të specializuara nën-rajonale për temën në fjalë. Diskutimet do të ndihmojnë rritjen e ndjeshmërisë gjimore dhe të përfshirjes së aftësisë së kufizuar në politikat dhe menaxhimin e URF-së në OSBE.

Objektivat kyçë

Objektivat kryesorë të tryezave të rrumbullakëta të specializuara për politika kombëtare me ndjeshmëri gjinore dhe me përfshirje të aftësisë së kufizuar në rajonin e OSBE-së janë si më poshtë:

- Përkrahja e nevojës për Ndjeshmëri Gjinore dhe Përfshirje të Aftësisë së Kufizuar për Uljen e Rrezikut të Fatkeqësive, politikat dhe menaxhimi.
- Diskutimi i përjasjeve rajonale, praktikave më të mira dhe ofrimi i rekomandimeve për politikat me ndjeshmëri gjinore dhe që përfshijnë aftësinë e kufizuar;
- Krijimi i themeleve të rrjetëzimit ndërmjet atyre që punojnë në këtë fushë, me qëllim rritjen e kapaciteteve kombëtare dhe vendore për ndërhyrje reaguese ndaj nevojave gjinore.
- Zhvillimi i rekomandimeve praktike për aktorët kyçë dhe strukturat ekzekutive të OSBE-së.

Do të hartohen rezultatet e diskutimeve (praktikat e mira, rekomandimet në nivel politikash, etj.) dhe do të ndahen në platformë të posaçme.

Publiku i synuar

Secila tryezë e rrumbullakët përmban dy seanca me dy panele të ndryshme të përbëra prej 3-4 ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë. Janë ftuar më shumë se 50 ekspertë nga strukturat kombëtare dhe vendore URF, nga grupet e shoqërisë civile dhe nga misionet dhe institucionet e OSBE-së, si dhe nga organizatat ndërkombëtarë. Në pjesën e fundit të ditës, pjesëmarrësve do u jepet mundësia për rrjetëzim.

Formati i takimit në internet

Aktiviteti do të zhvillohet në internet, me anë të platformës Zoom.

Gjuhët

Ofrohet përkthim simultan nga Anglishtja në Rusisht më 22 nëntor dhe nga Anglishtja në Shqip dhe në gjuhët Boshnjake/Kroate/Malazeze/Serbe më 23 nëntor. Me kërkesë, do të ofrohet përkthim Japonisht dhe në gjuhën e shenjave.

Regjistrimi

Jeni të lutur të [klikoni këtu](#) për të plotësuar formularin e regjistrimit brenda datës **17 nëntor 2021**. Pas kësaj date, ne do i dërgojmë linkun e takimit të gjithë pjesëmarrësve të regjistruar.

Informacion

Për çdo pyetje, ju lutemi të kontaktoni Beti Miloshoska-n (Beti.Miloshoska@osce.org), Ndhimëse Programi, Programi i Çështjeve Gjinore.



Tryezë e Rrumbullakët e Specializuar për Ndjeshmërinë Gjinore dhe Përfshirjen e Aftësisë së Kufizuar për Uljen e Rrezikut të Fatkeqësive (URF), Politikat dhe Menaxhimi

Azia Qendrore dhe Mongolia, 22 nëntor 2021

Evropa Juglindore, 23 nëntor 2021

Aktivitet në internet (UTC+1, sipas orës në Amsterdam, Berlin, Bernë, Romë, Vjenë)

PROGRAMI PARAPRAK

| | |
|--|--|
| 08:45 – 09:00 | Takim për kafe virtuale |
| 09:00 – 09:15 | <ul style="list-style-type: none">• Mirëseardhja nga organizatorët• Prezantim i shkurtër i objektivave të tryezës së rrumbullakët dhe i ekspertëve |
| SEANCA 1 - Pse është e rëndësishme ndjeshmëria gjinore dhe përfshirja e aftësisë së kufizuar për URF-në: Vlerësimi i gjendjes së politikave, planeve, strategjive dhe bazave ligjore në lidhje me ndjeshmërinë gjinore dhe përfshirjen e aftësisë së kufizuar | |
| 09:15 – 10:05 | <ul style="list-style-type: none">• Futja e barazisë gjinore dhe e aftësisë së kufizuar në kornizat dhe marrëveshjet e bashkëpunimit ndërkombëtare për URF-në – përfaqeset globale dhe rajonale për integrimin gjinor (Kuadri i Sendai-t, Programi dhe OZhQ-të 2030, CEDAW, Marrëveshja e Parisit, etj.) |
| 10:05 – 10:55 | <ul style="list-style-type: none">• Tablo e studimit paraprak për “Rritjen e Ndjeshmërisë Gjinore dhe Përfshirjen e Aftësisë së Kufizuar për URF-në, Politikat dhe Menaxhimi”• Politika, plane, strategji, baza ligjore dhe struktura qeveritare kombëtare gjithëpërfshirëse URF: Nga planifikimi tek zbatimi |
| 10:25 – 11:00 | <ul style="list-style-type: none">• Diskutim dhe Përmbledhje e Seancës 1 |
| PUSHIM 10-MINUTËSH | |
| SEANCA 2 - Qeverisja e URF-së: Kthimi i angazhimit të qeverisë për politika dhe strategji gjithëpërfshirëse URF në veprim | |
| 11:10 – 12:00 | <ul style="list-style-type: none">▪ Hendeqet dhe pengesat, mundësuat dhe faktorët kyç të suksesit të drejtimit të grave gjatë krizave dhe menaxhimi i URF-së në nivel komuniteti, vendi, dhe nën-rajoni, si dhe plane/rekomandime të zbatueshme |
| 12:00 - 12:50 | <ul style="list-style-type: none">▪ Raste studimore: praktikat e mira dhe mësimet në lidhje me integrimin e koncepteve gjinore dhe të aftësisë së kufizuar në politikat dhe menaxhimin e URF-së |
| 12:50 – 13:00 | <ul style="list-style-type: none">• Përmbledhje e Seancës 2 |
| 13:00 – 14:00 | <ul style="list-style-type: none">• Aktivitet anësor për rrjetëzim |